



BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

NJOFTIM

KRITERET E PËRFITIMIT TË BURSËS PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2024 - 2025

Baza ligjore: VKM NR.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, (i ndryshuar me VKM NR.854, datë 24.12.2019 , me VKM NR. 511, datë 27.7.2022) të Këshillit të Ministrave sipas të cilës përfitojnë bursë kategoritë e mëposhtme:

Pika	Kategoritë që përfitojnë bursë sipas VKM-së Nr.666 datë 10.10.2019 (i ndryshuar)	Dokumentat që duhen dorëzuar
KRITERI EKONOMIK		
2.1/a	Nxënësit e arsimit parauniversitar që e kanë shkollën mbi 5 km larg nga vendbanimi i tyre i përhershëm, me të ardhura sipas Pasqyrës 1 dhe që akomodohen në konvikt.	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. 17
2.1/b	Nxënësit e arsimit parauniversitar të cilët banojnë në zona rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes 5 km, të cilët plotësojnë kriterin sipas ekonomik sipas Pasqyrës 1 dhe që akomodohen në konvikt.	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. 17
2.1/c	Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë rregjistruar në arsimin bazë , por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.	1, 3, 4, 6, 17
KRITERI I REZULTATEVE TË ARRITURA		
2.2	Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notë mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).	1, 4, 6, 17, 18
KRITERI JOEKONOMIK		
2.3/a	Nxënësit që kanë përfituar statusin e jetimit	1, 4, 6, 9. 17
2.3/b	Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.	1, 4, 6, 10. 17
2.3/c	Nxënës që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara , të vërtetuar nga komisioni mjeko-ligjor	1, 4, 6, 11, 13.17
2.3/ç	Nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë	1, 4, 6, 11, 13 17
2.3/d	Nxënës fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit.	1, 4, 6, 12, 13. 17
2.3/dh	Nxënësit e pakicës rome dhe egjiptiane të cilët rregjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional.	1, 4, 6 , 14. 17
2.3/e	Nxënës që janë identifikuar dhe trajtuar si viktimat e trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror	1, 4, 6, 15. 17
2.3/ë	Nxënës fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.	1, 4, 6, 15. 17

2.3/f	Nxënëset (vajza) që ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë.	1, 4, 6. 17
2.3/g	Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.	1, 4, 6, 16. 17
2.3/gj	Nxënëset, të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja "F", e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës.	1, 4, 6. 17
2.4/a	Nxënësit të cilët ndjekin me kohë të plotë në drejtimet mësimore, bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës e gazit	1, 4, 6. 17
3	Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:	
3/a	Janë ndarë nga trangu familjar	
3/b	Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private	
3/c	Deklarohen mbetës ose përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluëse.	

Lista e dokumentave për të përfituar bursë

1. Certifikatë personale dhe familjare.
2. Vërtetim i Sigurimeve Shoqërore, ku përcakohet nëse prindërit ose anëtarë të tjerë të familjes mbi 18-vjeç, marrin ose jo pension apo shtesa të tjera.
3. Vërtetim nga Sektori i Ndihmës Ekonomike për kryefamiljarin. (përfiton ose jo)
4. Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar nxënësi apo vazhdon studimet, në cilën degë dhe cilin vit shkollor.
5. Vërtetim nga konvikti ku është akomoduar nxënësi.
6. Vërtetim i Tatim Taksave që ushtrojnë ose jo aktivitet privat, për çdo person mbi 18 vjeç.
7. Vërtetim nga Zyra e Punësimit për pjestarët e familjes, në moshën e punës që janë kërkues pune dhe nuk trajtohen me asistencë sociale.
8. Vërtetim page nga punëdhënësi(n.q.s janë në punë pjesëtarët e familjes).
9. Vërtetim i statusit të jetimit ose fotokopje e noterizuar të këtij statusi, të përfituar nga Shërbimi Social Shtetëror.
10. Vërtetim Gjykate i formës së prerë.
11. Vërtetim origjinal ose fotokopje e noterizuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (K.M.C.A.P), **për nxënësin** me aftësi të kufizuar.
12. Vërtetim origjinal ose fotokopje e noterizuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (K.M.C.A.P), **për prindin** me aftësi të kufizuar.
13. Vërtetim për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyra përkatëse.
14. Vërtetim nga Shoqata e Romëve/Egjiptianëve.
15. Vërtetim nga Ministria e Brendshme.
16. Certifikatë e vdekjes së prindit/ prindërve.
17. Vërtetim nga drejtori i shkollës dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.
18. Kopje e dëftesës së notave nga klasa paraardhëse.

Shënim: Dokumenteve që dorëzohen ju bashkëngjitet kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për aplikim burse.

Pasqyra Nr.1: KUSHTET EKONOMIKE PËR NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursë	Përfitojnë ½ bursë	Me pagesë
	Për qytetin	Me të ardhura mujore lekë/për frymë	Më të ardhura mujore leke / për fryme	Më të ardhura mujore leke / për fryme
1	Për familje me 2 persona	Deri 4.500	4.500 – 5.000	Mbi 5.000
2	Për familje me 3 persona	Deri 4.200	4.200 - 4.800	Mbi 4.800
3	Për familje me 4 persona	Deri 4.100	4.100 - 4.600	Mbi 4.600
4	Për familje me 5 persona	Deri 4.000	4.000 - 4.500	Mbi 4.500
5	Për familje me 6 persona	Deri 3.800	3.800 - 4.300	Mbi 4.300
6	Për familje me 7 persona	Deri 3.500	3.500 - 4.200	Mbi 4.200
7	Për familje me 8 persona	Deri 3.200	3.200 - 4.000	Mbi 4.100

Afati i dorëzimit të dokumentave për vitin shkollor 2024 – 2025 është data 15 Nëntor 2024.